



# DITARI MUJOR

Janar 2023



## Ceremonia e diplomimit e Universitetit të Elbasanit

Universiteti "Aleksandër Xhuvani" i Elbasanit zhvilloi ceremoninë e diplomimit të studentëve për vitin akademik 2021-2022. Ky ishte finalizimi i një rrugëtimi që nisi me sfidat e pandemisë dhe studentët ja dolën me përpjekje e përkushtim. Në fillim të hapjes së ceremonisë së diplomimit, studentët, prindërit e tyre dhe të pranishmit e tjerë kanë ndjekur një filmim të përgatitur nga stafi akademik i Universitetit "Aleksandër Xhuvani", i titulluar "Unë zgjedh të arsimohem në vendin tim". Një mesazh për të rinjtë, që të zgjedhin të arsimohen në Shqipëri dhe të punojnë për zhvillimin e vendit të tyre. Rektori i universitetit Prof.dr. Skender Topi në fjalimin e tij falenderoi stafin akademik për përkushtimin, studentët dhe prindërit e tyre, për besimin e tyre ndaj Universitetit "Aleksandër Xhuvani".

## Ceremoni në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike



Në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, u zhvillua ceremonia e dhurimit të pajisjeve teknologjike mësimore nga Ambasada e Kinës në Shqipëri, për Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani". Morën pjesë në këtë ceremoni, këshilltari Wang Dexin, zëvendësrektorja Peçi Naqellari dhe profesor Shkëlqim Hidri, dekan i Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike. Këshilltari Wang Dexin, pati shkëmbime miqësore me pedagogët dhe studentët mbi marrëdhëniet Kinë-Shqipëri, bashkëpunimin e arsimit të lartë dhe shkëmbimet kulturore midis dy vendeve.

## Takim me doktorantët e rinj



Rektori i Universitetit të Elbasanit Prof.dr. Skender Topi, zhvilloi një takim me doktorantët e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike. Pjesëmarrës në këtë takim ishin, zëvendësrektorja për kërkimin shkencor, dekani dhe personeli akademik i Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, si dhe profesorë të ftuar nga Universiteti i L'Aquila, Itali, të cilët ndanë me doktorantët rekomandime, udhëzime dhe këshilla të vlefshme në kërkimin e tyre shkencor.

### Gazetari Ksenofon Ilia në UE



Universiteti i Elbasanit mirëpriti në ambjentet e tij gazetarin e mirënjohur Ksenofon Ilia. Gjatë takimit, studentët e Fakultetit të Shkencave Humane u njohën me termin "Stenografi", rëndësinë, rolin dhe dobinë e përdorimi të tij në fusha të ndryshme. Për tu njohur më shumë këtë mënyrë komunikimi përmes shenjave, shkurtimeve ose simboleve mund të dërgoni e-mail në [ilia.foni70@gmail.com](mailto:ilia.foni70@gmail.com)

### Takim me maturantë në UE



Universiteti i Elbasanit, mirëpriti maturantë nga Shkolla e Mesme e Gjuhëve të Huaja, me qëllim njohjen dhe informimin mbi mundësitë, hapësirat dhe shërbimet e ofruara për studentët. Pjesë e këtij takimi, ishin përfaqësues nga Fakulteti i Shkencave Humane, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, si dhe nga Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë.

### Gazetari Mentor Kikia në UE



Studentë të programit të gazetarisë dhe gazetari-anglisht, gjatë një takimi frytdhënës me gazetarin e njohur Mentor Kikia. Përgjatë takimit Z.Kikia, ndau me studentët përvojat personale në fushën e gazetarisë, përshkrim të situatës aktuale të gazetarisë në vend, sfidat, detyrat dhe përgjegjësitë e një gazetari. Gjithashtu, nuk munguan as këshilla dhe rekomandime të vlefshme, për ushtrimin e këtij profesioni me integritet dhe profesionalizëm.

### Takim me Shkollën e Magjistraturës



Universiteti i Elbasanit organizoi një takim me Shkollën e Magjistraturës për të rritur ndërgjegjësimin për rolet dhe pozicionet e magjistratëve, këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë.